

KËRKESË
Nr. 1783, datë 11.4.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën, “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rruga hyrëse Berat” (shtesa), për pasuritë e llojit “truall”.

Subjekti kërkuar, i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr.138, datë 23.03.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “truall”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 2493068 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRUGA HYRËSE
BERAT" (SHITESA

Nr.	PRONARI			Z. Kad.	Nr. i pasurisë	Lloji i pas.	Sip. përgj. (m ²)	Sip. shpron. (m ²)	Çmimi (lekë / m ²)	Shuma (lekë)	Shuma totale në (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Rruzhdi	Ali	Orizaj	8501	2/175	truall	49	31	4183	129673	129673	Konf. nga ZVRPP-ja
2	Rruzhdi	Ali	Orizaj	8501	2/164	truall	220.6	83	4183	347189	347189	Konf. nga ZVRPP-ja
3	Besim	Bajram	Sherifi	8501	2/166	truall	66	20	4183	83660	83660	Konf. nga ZVRPP-ja
4	Besim	Bajram	Sherifi	8501	2/176	truall	49	15	4183	62745	62745	Konf. nga ZVRPP-ja
5	GANIMETE	Kamber	Orizaj	8501	1-May	truall	9224	447	4183	1869801	1869801	Konf. nga ZVRPP-ja
	SHUMA										2493068	